

V E N D I M

MBI RIREGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Në Tiranë sot më dt.25.IO.1993 unë gjyqtari i gjyktës rrethit Tiranë Donika Deti mora në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga kërkuasi Valeria Italo dhe N.B.Gosë për riregjistrimin e firmës "AGRIGOSË" e cila është e regjistruar si person juridik

K O N S T A T O V A

Se kërkesa e paraqitur nga kërkuasi për riregjistrimin e firmës "AGRIGOSË" duke marrë formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjin 7638 dt.19.11.1992 për shoqëritë "Tregtare" mbasi formalitetet e regjistrimit dhe kushtet materiale nuk i ka në përputhje me këtë ligj, është e drejtë dhe në bazë të ligjit duhet pranuar.


PËR KËTO ARSYE

Rëregjistrimin si person juridik të firmës "AGRIGOSË" duke marrë formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar "AGRIGOSË" me ortakë Valeria Italo dhe N.B.Gosë për të ushtruar veprimtarinë private në fushën e Kulturës dhe prodhimi i bimëve të fushës me teknologji moderne, transformimi industrial, koservimi, magazinimi në fjalë të ngjashme dhe impanti të specializuar import eksport, tregti me shumicë epakicë e produkteve bujqesore, laboratoriale, zëvendësimi i zotënikës, investime turistike, pjesëmarrje në shoqëri të tjera që kanë të njëjtin objekt ose të përafert me të.

Kunder vendimit lejohet ankimi në shkallë të dytë.

Tiranë më dt.25.IO.1993

GJYQTARE
DONIKA DETI



K O N T R A T E

Për krijimin e Ndërmarrjes së Përbashkët shqiptare -italiane në Gosë të rrethit të Kavajës :

Ndërmarrjes Bujqësore Gosë person juridik që vepron konform legjislacionit shqiptar me qendër në Gosë të rrethit të Kavajës e përfaqësuar nga drejtori i saj Zoti Bajram Saraçi nga njëra anë dhe

Nga ana tjetër shoqëria "Valeria Italia S.R.L." me qendër në Manfredonia Rruga G. G. Di Vittorio, 271 Italia që vepron në bazë të legjislacionit italian e përfaqësuar nga presidenti i shoqërisë Dott. Michale Cicella .

Të dy palët kanë rënë dakort për të krijuar një shoqëri të përbashkët Agro -ekonomike Industriale me emërtimin shqiptaro Italian " AGRIGOSË" Ndërmarrje agroindustriale me kushtet e mëposhteme.

- 1 -

Ndërmarrja e ka qendrën në Gosë të rrethit të Kavajës dhe zhvillon veprimtarinë e saj në bazë të kontratës , statutit dhe legjislacionit shqiptar.


Ndërmarrja do të ketë në përdorim një sipërfaqe toke bujqësore prej 582 ha dhe do të zërë në punë 650 puntorë ndër të cilët : 455 puntorë fushe , 78 bari , 67 mekanikë specialistë, 17 puntorë konstruksionesh (muratorë, elektrikistë, zdrukturë, hidraulikë etj) dhe 33 nëpunës ose drejtues nga të cilët 19 me diplomë të shkollës së mesme dhe 14 me shkollë të lartë.

- 2 -

Zgjatja e shoqërisë së përbashkët është theksuar deri me 30.12.2050.

- 3 -

Shoqëria ka për objektiv ,kultivimin dhe prodhimin e bimëve të fushës me teknologji të avancuar dhe moderne, transformimin industrial , konservimin, magazinimin në frigorifer dhe impiante të specializuara, importimin, eksportimin, ndërmjetësimin, tregtimin me shumicë e pakicë të prodhimeve bujqësore, zhillimin e zooteknikës, shërbimeve për të tretë, asistencë teknike, investime turistike, shitblerje prodhimesh për punonjësit dhe familjet e tyre, pjesëmarrjen dhe instalimin e ndërmarrjeve që kanë për objekt ushtrimin e të njejtit aktivitet ose ndihmës përfaqësimit e garancive reale dhe çdo lloj aktiviteti tjetër komplementar gjithmonë e lidhur në mënyrë indirekte në të.



Shoqëria mund të kryejë për më tepër të gjithë operacionin tregtar, industrial, financiar të lëvizshme ose jo të nevojshme dhe të domosdoshme për arritjen e objektivit social. Shoqëria mund të marrë kuota pjesëmarrje në shoqëri të tjera që ka objektiv të njëjtit dhe emrimin e kujdestarëve.

- 4 -

Kapitali shoqëror është vendosur në shumën 863.915 USD e cila është e ndarë në mënyrë të tillë:

Kapitali themelor	<u>66.391.500</u>	lekë	ose	<u>663.915</u>	usd
NB Gosë	<u>34.556.600</u>	lekë	ose	<u>345.566</u>	usd
Valeria Italia	<u>31.834.900</u>	lekë	ose	<u>318.349</u>	usd
Kapitali për pjesën e mjeteve të xhiros	<u>20.000.000</u>	lekë	ose	<u>200.000</u>	usd
NB Gosë	-	lekë	ose	-	usd
Valeria Italia	<u>20.000.000</u>	lekë	ose	<u>200.000</u>	usd.

Kapitali i partnerit shqiptar është përfaqësuar nga magazinat, stallet, lokalet e zyrave etjere si dhe pajisjet, kafshët, makinat etjere ashtu sic rezultoi nga inventari kopja e të cilit i bashkangjitet aktit të mëposhtëm në gërmën A. Ndërsa kapitali italian është përfaqësuar në natyrë për 318.349 USD në pajisje, impiante, mjete transporti dhe për 200.000 USD në përvojë. (para)

Kapitali i palës shqiptare do të shtohet në masën e vlefshme të tokës. Kjo pjesë e kapitalit do të shtohet me daljen e legjislacionit shqiptar mbi tokën. Në masën e rritjes së kapitalit që vendos pala shqiptare po në atë masë do të bëjë shtesën edhe pala italiane. Në rast se shtesa e kapitalit nga toka që afrohet pala shqiptare nuk shoqërohet me shtesën në të njëjtën masë të kapitalit nga ana e palës italiane atëherë do të ndryshojë kontributi në formimin e kapitalit të ndërmarrjes, për rrjedhojë do të ndryshojë edhe masa e ndarjes së fitimit.


Mjetet financiare duhet të jenë të depozituara në bankën kombëtare të Shqipërisë brenda 6 muajve nga data e lëshimit të autorizimit nga organet kompetente.

Në të njëjtën bankë do të hapet llogaria rrjedhëse e shoqërisë së përbashkët. Vlerësimi i ndërmarrjes do të bëhet në lekë e në valutë sipas rregullave të detajuara nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe do të aplikohet këmbimi zyrtar i ditës së fillimit të kontratës.

- 5 -

Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjes dhe investimi i ortakut të huaj do të garantohet nga shteti shqiptar, që u siguron atyre të njëjtin trajtim si personat juridikë shqiptarë.

VALERIA ITALIA s.r.l.
L'Amministrazione Unico



në bazë të legjislacionit përkatës shqiptar.

- 6 -

Ndërmarrja fillon aktivitetin e saj pasi të marrë autorizimin nga organet kompetente shqiptare, sipas kërkesës që do të paraqesin të dy ortakët. Ndërmarrja ndalon aktivitetin e saj në momentin e mbarimit të kontratës (30.12.2050).

Palët kanë të drejtë të heqin dorë nga kontrata duke komunikuar me shkrim palës tjetër të paktën 12 muaj më parë. Ortaku që heq dorë nga shoqëria nuk mund të largohet pa shlyer detyrimet ndaj ortakëve të tjerë të shoqërisë. Në fund të kontratës palët kanë mundësi ta rinovojnë.

- 7 -

Ndarja e likujdimit të ardhurave neto që rezultojnë nga bilanci duke hequr 5 % për rezervën e zakonshme deri sa kjo të arrijë 1/5 e kapitalit bëhet sipas modaliteteve të treguara në statutin e shoqërisë.

- 8 -

Veprimtaria financiare e shoqërisë mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Veprimi i parë shoqëror do të mbyllet më 31 Dhjetor 1993.

- 9 -

Në librin kontabël të shoqërisë shënohen fondi bazë i përbërë nga kapitali i nënshkruar i secilës palë.

Palët nuk janë të ndaluara në mundësinë e rritjes së kontributit të tyre për formimin e kapitalit shoqëror në ndërmarrjes. Partneri Italian autorizohet herë pas here nga partneri Shqiptar të transferojë sipas legjislacionit shqiptar partnerëve të tjerë të huaj kuota të pjesëmarrjes në shoqërinë e përbashkët

- 10 -

Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me fondet e saja. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet e mundshme në lidhje me shtetin shqiptar ose privat, të kontraktuara nga palët para firmimit të aktit, as edhe për punët personale të vetë palëve që përbëjnë ndërmarrjen.

- 11 -

Ndërmarrja bën projekte teknike të nevojshme për aktivitetin e saj. Aktiviteti prodhues e financiar i ndërmarrjes zhvillohet sipas planit të formuluar nga shoqëria në fillim të vitit sipas statutit të saj.



Të drejtat e palëve kontraktuese janë:

- Të marrin pjesë në drejtimin e ndërmarjes (drejtim teknik e administrativ).
- Të marrin pjesë në ndarjen e fitimit në proporcion të kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin social.
- Të rimarrin pjesën e kapitalit në rastin e ndalimit të aktivitetit, gjithmonë në proporcion me kuotat e pjesëmarrjes .

Detyrimat e palëve janë:

- Të hedhin kuotën e saj në kapitalin social sipas pikës 4 që është në kontratë .
- Të marrin pjesë në drejtimin e ndërmarjes , duke respektuar statutin dhe legjislicionin shqiptar .
- Të veprojnë për suksesin e ndërmarjes .

Organizimi dhe drejtimi i ndërmarjes do të parashikohen në statut.

Raportet e punës në ndërmrje rregullohen nëpërmjet kontratës së punës konformë legjislacionit shqiptar.

Mos marrëveshjet midis puntorëve dhe ndërmarjes zgjidhen nga gjyqji shqiptar.

Paga e puntorëve është fiksuar midis palëve në momentin e krijimit të shoqërisë së përbashkët në 150 lekë dhe mund të ngrihet me vendim të Këshillit Administrativ duke konsideruar prodhimtarinë e ndërmarjes .


Puntorët shqiptarë janë siguruar në bazë të legjislacionit shqiptar mbi sigurimet shoqërore .

Mos marrëveshjet që mund të lindin midis palëve do të zgjidhen nga Arbitrazhi i Dhomës së Tregtisë Ndërkombëtare në Paris sipas procedurave të tij .

Ligji i zbatueshëm do të jetë ai zvicerian.

Administrimi i shoqërisë i besohet Këshillit Administrativ i përbërë nga 7 (Shtatë) që mbetet në fuqi deri në dorëheqjen ose pushimin .

Organi administrativ është i veshur me fuqi më të mëdha për të gjitha aktet të administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë pa përjashtim.



Përfaqsimi legal i shoqërisë në mendim dhe firma shoqërore i takon presidentit të Këshillit Administrativ dhe bazë të kufijve të fuqive të dhëna administrator të dërguar e të emruar .

Palët përbërëse në unanimitet vendosin të emrojnë në Këshillin Administrativ zotërinjtë:

1. Dott. Michele Cicella
2. rag. Domenico Di Candia
3. Rag. Carlo Bonura
4. Rag Mateo Robustalla
5. Sig. Bajram Saraçi
6. Sig. Rakip Skuqi
7. Sig. Selman Sheshi (Selman Sheshi)

të cilët pranojnë detyrën e dhëna.

- 18 -

Shoqëria deklaronet e krijuar nën mbikqyrjen e plotë dhe përbushjen e plotë si të normave që përmban ky akt ashtu dhe ato që përmbahen në statutin social , që palët deklarojnë e i kanë lexuar me vëmendje , diskutuar e ekzaminuar në çdo pjesë të saj dhe që në shenjë aprovimi e pranimit nënshkruhet nga ato në kopje dhe në fund të çdo flete të ndërmjetme që i bashkangjitet në gërmën D aktit presid. në të cilën do të bëjë pjesë integrale dhe përbërëse në çdo kohë.

- 19 -

Për cka është thënë shprehimisht në kontratën e statutin e mëposhtëm i referohemi dispozitave të ligjit në fuqi dhe vecanërisht ligjit për mbrojtjen e investimeve të huaja (Nr 7594 datë 11.8.1992 e modifikimeve e integritimeve të mëtejshme).

Akti i mësipërm redaktohet sot në Gosë të rrethit të Kavajës në dy origjinale nga të cilat një në gjuhën shqiptare dhe një në gjuhën italiane , duke patur të dyja të njetat vlera juridike dhe firmosur nga të dyja palët që e deklarojnë konformë vullnetit të tyre.

4 FEB. 1993

Për ortakun Italian

Valeria Italia S.R.L.

Presidenti

Dott. Michele Mario Cicella

Për ortakun Shqiptar

Ndërmarrja Bujqësore Gosë

Drejtori

Bajram Saraçi

VALERIA ITALIA s.r.l.
Amministratore Unico



KONTRATE TRANSFORMIMI E SHOQERISE "AGRIGOSE" NE SHOQERI ME
PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "AGRIGOSE" SH.P.K.

MIDIS

Ndermarrjes N.B.GOSE,ndermarrje shteterore,ekrijuar dhe qe zhvillon aktivitetin e saj ne baze te legjislacionit shqiptar,me qender ne Gose,te rrethit te Kavajes,e perfaqshuar nga drejtori i saj z.Bajram Saraçi,nga njera ane

DHE

Shoqerise VALERIA ITALIA S.R.L.,person juridik ne baze te legjislacionit italian,me qender ne Manfredonia(FG),rruga G. di Vittorio 271 - Itali,e perfaqshuar nga Administratori i plotfuqishem z. Michele Cicella,i veshur me fuqite me te medha per te gjitha aktet e administrimit te zakonshem dhe te jashtzakonshem te shoqerise,pa asnje lloj perjashtimi, nga ana tjeter.

DUKE PRANUAR

- a) qe me date 4 shkurt 1993 eshte firmosur ne Gose kontrata per krijimin e shoqerise AGRIGOSE- Ndermarrja agroindustriale shqiptare-italiane, midis N.B.GOSE dhe shoqerise VALERIA ITALIA SRL.
- b) qe me vendim nr 193 date 19 shkurt 1993 Ministria e Bujqesise e Republikes se Shqiperise dha aprovimin e saj ;
- c) qe me vendim nr 17 date 18 mars 1993 Ministria e Tregetise se Jashtme dha aprovimin e saj;
- d) qe me date 20 mars 1993 shoqeria Agrigose u njoh si person juridik nga ana e Gjykates se rrethit Kavaje,ku eshte regjistruar me numer 370;
- e) qe aktiviteti ekonomik i shoqerise AGRIGOSE dhe investimi i ortakut te huaj(VALERIA ITALIA) garantohen nga shteti shqiptar ne baze te legjislacionut shqiptar ne fuqi,per kete problem (ligji nr 7594 i 11 gushtit 1992 me ndryshimet dhe shtesat e mevonshme)




f) qe shoqeria Agrigose zhvillon rregullisht aktivitetin e saj
Duke pranuar te gjitha keto kushte mund te nenshkruajme per sa
me poshte :

- 1) Kushtet bejne pjese i ntegrale dhe thelbesore te aktit prezent
- 2) Midis paleve eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufi-
zuar nen emrtimin "AGRIGOSE" - SH.P.K.
- 3) Shoqeria e ka seline ne Gose te rrethit te Kavajes, SHQIPERI.
- 4) Kohezgjatja e shoqerise eshte fiksuar deri me 31dhjetor 2050.
- 5) Shoqeria ka per objekt :

- kultivimin e tokes dhe prodhimin e produkteve te fushe me tek-
nologji moderne ,transformimin industrial,konservimin dhe ruaj-
tjen ne magazinanfrugorifere dhe inpiante te specializuara,imp-
ortin,eksportin,ndermjetesimin,perfaqsimin me ose pa depozitim
ne Shqiperi apo jashte saj,tregetine me shumice dhe me pakice
te produkteve bujqesore,zhvillimin e zooteknikes,sherbime per te
trete,konsulence teknike,investime turistike,shitblerjen e pro-
dhimeve per punonjesit dhe familjet e tyre,administrimin dhe
dhenien me qera te ndermarrjeve qe kane per objekt ushtrimin e
veprimtarive te tilla ,perfaqsimin e garancive edhe reale,dore-
zanie per obligacione per vete ose per te tjere,qdo lloj akti-
viteti shtese qe ka per qellim kryerjen e atyre qe treguam.
Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tre-
getare,industriale,financiare,te nevojshme ose te domosdoshme
per arritjen e objektivit social ,perfshire dhe marrjen e kre-
dive hipotekare te tundshme apo jo. Shoqeria mund te marre kuota
perfaqesimi dhe ne shoqeri te tjera ne Shqiperi ose jashte saj,
qe kane objekt analog ose te perafert me te dhese fundi te eme-
roje kujdestare.

- 6) Kapitali shoqeror eshte vendosur ne shumen ne leke 86.400.000
i barazvlefshem me lit. 1.296.000.000.,i ndare ne kuota sipas
nenit 38 te ligjit NR 7638 dt 19/11/1992.

Ky kapital pranohet dhe nenshkruhet nga te dy ortakët theme-
lues , N.B.Gose me sasine ne leke 34.560.000,baraz me



lit. 518.400.000. dhe me nje perqindje 40%; shoqeria Valeria Italia me sasine ne leke 51.840.000, baraz me lit 778.600.000. dhe me nje perqindje prej 60%.

Kapitali i nenshkruar nga N.B.Gose perfaqsohet nga vlera e magazinave, stallave, lokaleve, zyrave ,mjete pune, kafshe ,makineri, ambalazhe, ashtu siç rezulton nga inventari, i cili ne kopje i bashkangjitet aktit prezent nen germen "B", si dhe nga perdorimi aktualisht gratis i terrenit (Ha 582), siç rezulton nga planimetria qe gjithashtu i bashkangjitet ketij akti nen germen "C", vlera e te cilit, gje qe do te vendiset ne baze te legjislacionit shqiptar mbi token, do te perfaqsoje nje rritje te metejshme te perfaqsimi te ortakut shqiotar ne shoqeri.

Kapitali i nenshkruar nga VALERIA ITALIAS.R.L.PERFAQSOHET NGA SAsia ne monedheper shumen ne leke 20.000.000. baraz me lit. 30000000 derdhja e te ciles ne kasen e shoqerise, siç rezulton nga regjistrat kontabel, eshte kryer tashme, si dhe kontributi ne natyre per lite 478.600.000. baraz me leke 31.840.000., ashtu siç rezulton nga inventari, i cili ne kopje i bashkangjitet aktit prezent me germen "D".

Prandaj kapitali shoqeror prej 86.400.000. lekesh baraz me lit 1.296.000. rezulton plotesisht i derdhur.

Ne baze te kontributeve respektive N.B.GOSE merr nje numer prej 34.560 kuotashme vlere 1000 leke secila, shoqeria VALERIA ITALIA merr nje numer prej 51840 kuotash me vlere prej 1000 leke secila Pra kapitali shoqeror i fiksuar ne lite 1.296.000.000. i nenshkruar dhe teresisht i derdhur eshte ndare midis ortakeve themelues siç eshte specifikuar me siper.

7) Aktiviteti shoqeror mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti; aktiviteti i pare mbyllet me 31 dhjetor 1993.

8) Te ardhurat neto qe rezultojne nga bilanci, duke hequr 5% per rezerve te zakonshme, deri sa kjo te arrije 1/5 e kapitalit shoqeror, do te ndahen midis ortakeve ne proporcion te kuotave te pjesmarrjes ne kapitalin shoqeror, perveç ndonje vendimi lidhur me kete te Asamblese.



9) Administrimi i shoqerise i besohet nje Keshilli Administrativ i perbere nga pese ose shtate vete, qe mund te mos jene ortake dhe qe vazhdojne ne detyre deri ne shkarkim ose ne doreheqje Organi administrativ eshte i veshur me te gjitha kompetencat per aktet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqeriae pa perjashtim.

Perfaqsimi legal i shoqerise perballe te tretteve dhe firma legale i takojne Presidentit te Keshillit Administrativ, dhe ne baze te kompetencave te dhena Anetareve te K.A. te deleguar prej tij.

Ortaket themelues ne unanimitet vendosin te emrojne anetare te keshillit Administrativ zoterinjte :

- 1) CICELLA ~~BOK~~.MICHELE
- 2) DI CANDIA Domenico
- 3) BORRECA Carlo
- 4) ROBUSTELLA Matteo
- 5) Bajram SARACI
- 6) Rakip SKUQI
- 7) Selman SHESHI

te cilet te mbledhur ne Keshill zgjedhin si President te Keshillit Administrativ z. MICHELE CICELLA.

Te emeruarit anetare te K.A. deklarojne se pranojme detyren e ngarkuar dhe qendrojne te veshur me fuqite e dhena nga ligji dhe statuti

Themeluesit perseri ne unanimitet vendosin te emerojne provizorisht revizore zoterinjte:

- 1) PACILLO Paolo
- 2) CARRILLI Maria Antonietta
- 3) Azem KOLA
- 4) DI TULLIO Jessica
- 5) Ilir ISMAILI

tre te peret efektive dhe dy te tjeret zevendesues.

Z. PAOLO PACILLO emerohet kryetar i keshillit te revizoreve



- 10) Shoqeria quhet e krijuar duke iu nenshtruar plotesisht si dhe duke patur parasysh detyrimet qe permban si kontrata prezente ashtu edhe statuti, te cilat ,palet deklarojne se i kane lexuar me vemendje, diskutuar dhe ekzaminuar ne çdo pjese, dhe qe ne shenje aprovimi nenshkruajne ato ne çdo fund faqeje ne mes te fashikullit dhe bashkangjitet nen germen "A" aktit prezent, duke bere gjithnje pjese perberese ne te
- 11) Presidenti i K.A. z. Michele Cicella eshte shprehimisht i deleguar te beje te gjitha ndryshimet e duhura nga kontrata dhe statuti, shtesa dhe ndryshime qe mund te krijohen me kerkesen e autoriteteve kompetente te drejtesise ne qendren e regjistrimit
- 12) Tegjitha mosmarrveshjet ne lidhje me zbatimin e kesaj kontrate do te tentohet te zgjidhen ne rruge miqesore ndermjet paleve. Nese nje gje e tille nuk do te arrihet atehere palet mund t'i drejtohen nje arbitrazhi nderkombetare ne Dhomen Nderkombetare te Tregetise ne Paris
- 13) Per çfare nuk eshte thene ne aktin prezent dhe ne statut i referohemi dispozitave ligjore ne fuqi per kete çeshtje.
- 14) Shpenzimet per kete akt dhe per rrjedhimet e tij jane ne ngarkim te shoqerise
- 15) Akti prezent redaktohet sot me 22/10/1993 ne Gose te rrethit te Kavajes ,Republika e Shqiperise, ne dy origjinale nga te cilet nje ne shqip dhe tjetra ne italisht, duke patur te dyja te njejten vlere juridike, dhe firmoset nga palet kontratuese qe e deklarojne ate konform vullnetit te tyre.
Perbehet nga 5 flete te daktilografuara me shirit te pafshishem.

Ndermarrja Bujqesore Gose


"Valeria Italia"s.r.l.

Drejtori
Bajram Saraçi



22 OTT. 1993

Presidenti
Michele Cicella
VALERIA ITALIA S.R.L.
L'Amministratore Unico



S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE
KUFIZUAR "AGRIGOSE" SH.P.K.

EMERTIMI, SELIA, KOHEZGJATJA , OBJEKTI

Neni 1

Eshte krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar nen emertimin "AGRIGOSE" SH.P.K. ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.(ligji 7638 dt 19/11/1992)

Neni2

Shoqeria e ka qendren ne Gose te rrethit te Kavajes Republika e Shqiparise dhe mund te ngraje dhe suprimoje sukursale,agjensit perfaqsimi edhe ne vende te tjera,ne Shqipari dhe jashte saj.

Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise eshte fiksuar deri me 31 dhjetor te vitit 2050

Shoqeria mund ta shtyje afatin ose ta shkurtoje ate me vendim te Asamblese se ortakeve.

Neni 4

Shoqeria ka per objekt :

Kultivimin e tokes dhe prodhimin e produkteve te fushes me teknologji moderne,transformimin industrial,konservimin dhe ruajtjen ne magazina,frigorifere dhe impiante te specializuara, importin,eksportin,ndermjetesimin,perfaqsimin me ose pa depozitim,ne Shqiperi apo jashte sajtregetine me shumice dhe me pakice te produkteve bujqesore,zhvillimin e zooteknikes,sherbime per te trete ,konsulence teknike,investime turistike,shitblerjen e prodhimeve per punonjesit dhe familjet etyre,perfaqsimin e garancive edhe reale,dorezanie per obligacione per vete dhe per te trete qdo lloj aktiviteti shtese qe ka per qellim kryerjen e atyre qe treguam.



Shoqeria mund te kryeje gjithashtu te gjitha operacionet tregeta re, industriale financiare, te nevojshme ose te domosdoshme per arritjen e objektivit social, perfshire dhe marrjen e kredive hipotekare te tundshme apo jo.

Shoqeria mund te marre kuota perfaqsimi dhe ne shoqeri te tjera ne Shqiperi ose jashte saj, qe kane objekt analog ose te perafert me te dhe se fundi te emroje kujdestare.

Neni 5

Kapitali shoqeror i shoqerise eshte 86400000 Leke dhe eshte i ndare ne kuota sipas nenit 38 te ligjit 7638 dt 19/11/1992

Neni 6

Financimet e kryera nga ortakët shoqerise ne baze te pjesemarrjes respektive ne kapital, nuk do te jene produkt i asnje lloj interesi.

Neni 7

Ne rast te leshimit te kuotave te perfaqsimi u rezervohet se pari ortakeve te tjere e drejta e blerjes ne raport me perfaqsimet respektive.

Ne rast se disa nga ortakët nuk duan te blejne kuotat, kjo e drejte mund te ushtrohet nga te tjeret ne baze te kuotave qe ato zoterojne.

Ushtrimi i te drejtes se blerjes duhet te behet te brenda 30 diteve nga data e marrjes se propozimit qe leshuesi duhet t'u dergoje te gjithë ortakëve te tjere nepermjet nje letre rekomande Ne rast se blerjes nuk behen nga ortakët ,atehere, transferimi i kuotave do te jete i lire, perveç rasteve te parashikuara nga neni 10 te ketij stat uti.



Neni 8

Marrja e kuotave nga çdo person apo kushdo qofte eshte i pavlefshem kundrejt shoqerise pa konsensusin paraqarak te Organit Administrativ

Neni 9

Ortaket kane te drejte te terhiquen nga shoqeria duke komunikuar me shkrim te pakten 12 muaj me pare. Terheqja e ortakut nuk e liron ate nga obligimet ndaj shoqerise.

Neni 10

Kapitali i shoqerise i fiksuar ne 86.400.000 leke, i ndare ne kuota ne baze te ligjit, nga te cilat 40% N.B.GOSE dhe 60% VALERIA ITALIA S.R.L., mund te rritet ose te zvogelohet me vendim te Asamblese se jashtezakonshle te ortakeve.

Ne rast te rritjes se kapitalit shoqeror ortaket lejojne shprehi misht qe SIMEST S.P.A. te mund te bleje kuota te shoqerise per nje vlere jo me te madhe se 14% te kapitalit shoqeror te AGRIGOSE sh. p.k., duke hequr dore tani per tani nga e drejta qe u takon atyre per blerjen. Gjithashtu SIMEST S.P.A. do te kete lehetsine per t'i dhene VALERIA ITALIA-s kuotat e saj te kapitalit brenda nje kohe prej tete vjetesh, me heqjen dore te ortakeve te tjere te shoqerise nga e drejta qe u takon per blerjen e kuotave.

Neni 11

Asambleja e mbledhur rregullisht perfaqson teresine e ortakeve dhe vendimet e marra nga ajo ,ne baze te ligjit dhe ketij statutit obligojne te gjithe ortaket.

Asambleja mund te mblidhet edhe jashte selise shoqerore, ne Shqiperi apo jashte saj. Asambleja e zakonshme duhet te mblidhet te pakten nje here ne vit, brenda 4 muajsh nga mbyllja e aktivitetit shoqeror.

Ne rast te nje arsye te veçante Organi Administrativ ka mundesi-



ne ta zgjase kete afat deri ne 6muaj.

Neni 12

Asamblete si ne thirrjen e pare edhe ne te dyten, thirren nga Organi Administrativ nepermjet nje letre te rekomanduar qe permbane rendin e dites dhe qe duhet te dergohet te pakten tete dite para mbledhjes ne shtepine e secilit prej ortakeve adresa e te cileve rezulton ne librin e ortakeve.

Ne lajmerimin qe i dergohet duhet te shenohet vendi, ora, e mbledhjes dhe lista e ceshtjeve qe do te trajtohen.

Mund te jene te shkruara edhe vendi, data, ora e mbledhjes tjeter

Ne mungese te formaliteteve te mesiperme, asamblea mund te quhet rregullisht e mbledhur ne rast se eshte prezent i gjithe kapitali shoqeror dhe administratoret, nese jane zgjedhur, dhe pjestaret e Keshillit te revizoreve.

Neni 13

I takon Presidentit te asamblese dhenia e te drejtes se nderhyjes ne asamble, dhe ne baze te dispozitave ligjore mbi perfaqsimin me ane te delegimit.

Neni 14


Asamblea drejtohet nga Presidenti i Keshillit te Administrimit dhe ne mungese, nga persona te tjere te zgjedhur nga te pranishmit.

Neni 15

Asamblea eshte e zakonshme dhe e jashtezakonshme.

Asamblea e zakonshme ne thirrjen e pare quhet rregullisht e mbledhur nese ortaket e pranishem ose me te deleguar, perfaqsojne me shume se gjysmen e kapitalit shoqeror dhe vendimet e saja jane te vlefshme nese merren me voten e favorshme te shumices absolute te te pranishemve.

Asamblea e zakonshme ne thirrjen e dyte eshte e rregullt, sado



qe te jete sasia e kapitalit te perfaqsuarddhe vendimet e saj jane te vlefshme nese merren me voten e ortakeve qe perfaqsojne shumicen e te pranishmeve.

Asamblea e jashtezakonshme si ne thirrjen e pare edhe ne te dyten quhet rregullisht e mbledhur me prezencen e aq ortakeve qe perfaqsojne vete ose nepermjet delegimit te pakten 3/4 e kapitalit shoqeror dhe vendimet e saja jane te vlefshme nese merren me voten e favorshme te ortakeve qe perfaqsojne shumicen e te pranishmeve.

Neni 16

Asamblea emerone nje sekretare, qe mund te mos jete ortak.

VENDIMET E Asamblese shenohen ne procesverbalin i cili firmoset nga Presidenti dhe Sekretari.

ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

Neni 17

Administrimi i shoqerise i besohet nje Keshilli Administrativ te perbere nga pese ose shtate vete, qe mund te mos jene ortake, te cilet jane ne detyre deri ne doreheqje ose largimin e tyre.

Neni 18


Keshilli zgjedh midis anetareve nje president dhe nje Menpresident dhe mund te delegoje pjese te fuqive te tij, perfshire dhe perdorimin e firmes shoqerore, njerit ose me shume anetareve te tije duke i caktuar atributet dhe caqet si dhe shperblimin.

Keshilli mund te emerone nje sekretar qe mund te mos beje pjese ne kete organ.

Neni 19

Keshilli i administrativ mblidhet me thirrjen e Presidentit qe behet me ane te nje letre te rekomanduar administratoreve dhe revizoreve, nese emerohen, te pakten pese dite para nga data e cakruar per mbledhjen

Presidenti duhet ta mbledhe keshillin edhe me kerkesen me shkrim



dh te motivuar te nje prej administratoreve. Merast te neglizhen-
ces apo mospranimit te presidentit thirrja mund te organizohet ne
menyre te vlefshme nga dy prej anetareve te K.A.

Ne rast urgjence thirrja mund te kryhet nepermjet telegramit ose
telex te konfirmuar, te pakten dy dite para dates se mbledhjes.

Ne mungese te formaliteteve te dhena keshilli quhet rregullisht
i mbledhur nese jane prezent te gjithë administratoret dhe revizi-
zoret , nese jane emeruar.

Per vlefshmerine e vendimeve eshte e nevojshme prezenca e shum
ces se administratoreve ne fuqë. Ne rast te barazise se votave
vendos ajo e presidentit.

Neni 20

Organi Administrativ eshte i veshur me fuqite me te medha per
aktet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te
shoqerise, pa perjashtim, dhe veçanerisht i njihen te gjitha lehte
site per arritjen e qellimit social te cilat nuk jane rezervuar
ne menyre te prere , me ligj ose nga ky statut per asamblene e
ortakeve. Ai mund te emroje gjithashtu kujdestare speciale per
kryerjen e akteve dhe kategorive te caktuara aktesh.

Kompesimet qe u takojne anetareve te K.A. vendosen nga asamblea
e ortakeve.

Neni 21

Perfaqsimi legal i shoqerise perballe te treteve dhe firma
shoqerore u takojne presidentit te K.A., ose ne varesi te fuqive te
dhena , anetareve te K.A. te deleguar prej tij.

Neni 22

Keshilli i revizoreve nese krijohet nga asamblea, perbehet nga tre
anetare faktive dhe dy zevendesues, te emeruar nga asamblea e za-
konshme, qe zgjedh edhe presidentin dhe cakton shperblimin.



Neni 23

Shoqeria mund te kete llogari rrjedhese ne banka te Republikes se Shqiperise, ose ne banka te huaja, sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 24

Aktiviteti shoqeror mbyllet me 31 dhjetor te çdo viti.

Ne fund te aktivitetit, Organi Administrativ ne baze te dispozitave ligjore dhestatutit ben bilancin shoqeror dhe llogaritjen e fitim humbjeve, duke e shoqeruar me nje relacion mbi mbarevajtjen e ndermarrjes.

Neni 25

Nga fitimi neto qe rezulton nga bilanci do te hëqet 5% per tu lene si rezerve e zakonshme, deri sa kjo te arrije nje te pesten e kapitalit.

Mbetja dote ndahet midis ortakëve ne proporcion me kuotat e perfaqesimit ne kapitalin shoqeror perveç ndonje vendimi te Asamblese

Neni 26

I gjithë dokumentacioni shoqeror dhe komunikimet e shoqerise ortakëve, perfshire dhe bilancin shoqeror, do te mbahen ne gjuhët shqip dhe italisht.


Neni 27

KONTRATA TE NDALUARA

Jane te ndaluara, me denim anullimin, kontratat e stipuluara ne çdo lloj forme, nepermhet te cilave administratoret ose ortakët qe nuk jane persona fizike, fitojne:

- a) hua nga ana e shoqerise
- b) paradhenie nga shoqeria
- c) qe shoqeria te paraqitet garant per borxhet qe ata kane kundrejt te treteve

Ky ndalim perfshin edhe kontratat e mesiperme te stipuluara midis shoqerise dhe perfaqesve legal te personeve juridike private.



Neni 28

Shoqeria prishet me perfundimin e afatit te caktuar nga neni tre i ketij statuti,ne qofte se nuk eshte vendosur nga asamblea e orta keve, zgjatja e afatit ose prishja e parakohshme e shoqerise.

Neni 29

Kur arrihet ne prishjen e shoqerise Asamblea e jashtezakonshme vendos per modalitetet e likujdimit,dhe emerone nje ose me shume likujdues,duke i caktuar te drejta dhe shperblimin.

Neni 30

Mosmarrveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe ortakeve, midis administratoreve dhe likujdatoreve,ne baze te statutit prezent,do te vendosen nga gjykata kompetente shqiptare,ose me mire nga nje kolegji prej tre arbitrash te emeruar nje nga secila pale dhe nje tjetere nga kryetari i gjykates se kasacionit ne Tirane.

Neni 31

Per çfare nuk eshte thene shprehimisht ne kete statut i referohemi legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht ligjit per mbroj tjen e investimeve te huaja(nr 7594 dt 11/08/1992),ligjit per shoqerite tregtare(NR 7638 dt 19/11/1992),ashtu edhe ligjeve nderkombetare per kete ceshtje,veçanerisht normativave te Komunitetit Evropian ,per aq sa ato jane te zbatueshme.

PARTNERI ITALIAN

VALERIA ITALIA S.R.L.

Administratori i plotfuqishem

Dok. Michele Cicella

VALERIA ITALIA S.R.L.
L'Amministratore Unico

PARTNERI SHQIPTAR

N.B.GOSE

Drejtori

Bajram Saraçi